

VENDIM
Nr.69, datë 1.10.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “GSA” SHPK
NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a” dhe nenit 45 pikat 3,4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1, germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datës 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1.Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2.Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta